



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**RAPORTI I EKSPERTIT TEKNIK**

<i>Visar BIBAJ – Exp. Shqyrtues</i> <i>Jeton Prenaj – Exp Teknik</i>	<i>Data e autorizimit të ekspertit</i> <i>28.09.2021</i>	<i>Data e dorëzimit të raportit</i> <i>06.10.2021</i>
---	---	--

## 1. BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.09.2021, OE “Pet Care” shpk dhe me datën 21.09.21 OE Al Tech shpk, kanë parashtruar ankesë me nr: 685 – 692-21, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me ushqim të terur për qentë zyrtar”, me nr. të prokurimit: 214-21-5862-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 44 200,00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

## 2. PRETENDIMET ANKIMORE

### DISPOZITAT E SHKELURA NGA AK SIPAS OE ANKUES – PET CARE shpk

Neni 1, Qëllimi,

- A Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,
- A Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- A Neni 51, Kriteret e Përzgjedhjes,
- A Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi,
- A Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës
- P Neni 62, Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit.

Raporti i teknik, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE Pet Care shpk dhe OE Al Tech shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me ushqim të terur për qentë zyrtar”, me nr. të prokurimit: 214-21-5862-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës.

1. Dispozitat e Rregullave dhe Udhëzuesit operativ të prokurimit publik (RRUOPP)

- A Neni 39.6, Sqarimi i tenderëve,
- A Neni 41, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve,
- A Neni 44, Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit.

DEKLARATA DETALE NE ANKESE

Te pa kënaqur me vendimin e AK lidhur me vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, atëherë ne pajtim me rregullat për parashtrimin e kërkesave/ankesave dhe ne afat ligjorë paraqesim këtë ankese në OSHP, me pretendimin AK ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-se dhe RRUOPP të cekura me lartë.

Pretendimet tona gjate kërkesës për rishqyrtim kanë qene që, AK kundërligjshëm na trajton si tenderues i eliminuar dhe pa te drejte dhe në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 44.5 të RRUOPP anulon aktivitetin e prokurimit edhe pse ne kemi qene të përgjegjshëm dhe në pajtim të plotë me kërkesat e parapara në Njoftim për kontratë , Dosje të tenderit dhe specifika teknike AK ne letrën standarde formularin B42 na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit me arsyetimin se: **Klinika Veterinare PET CARE- Nuk i përmbushë specifikat teknike të paketimit.**

Te pa kënaqur këtij vendimi kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim brenda afatit ligjorë, kërkesën për rishqyrtim e gjeni te bashkëngjitur ne fund të kësaj ankese lidhur me pretendimet tona të paraqitura në kërkesë për rishqyrtim..

AK, pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim, merr vendim për refuzim të kërkesës me arsyetimin se:

kërkuara ne dosjen e tenderit te Aneksi 1: **Pakctimi i Ushqimit duhet te kctë matrcial për ruajtjen e vlerave ushqyesc te ushqimit me standardc BOPP/PET met/LDPE. nuk i përmbushë specifikat tcknikc te paketimit, ambalazhimit te ushqimit për qen. Duke u bazuar ne katalogut e OE te dërguar ne dosjen e tenderit.**

Pas kërkesë për sqarime nga AK, OE c dergon edhe një dokument shtesc i cili dokument është nga një shtet tjetër nga prodhuesi. Prodhuesi i ushqimit dhe paketimit ne këtë rast është Rcpublika e Cekis ne bazë te katalogut te OE ne DT. Ndersa dokumentacioni shtcsë qe është dërguar nga OE për ambalazhim dhc paketim është nga republika e Italisë nuk është dokumenti i kompanisë prodhuese te ushqimit për qen qe oferton OE ne fjale ne DT. AK. nuk ka ber shkelje te nenit 39.6 pasi AK ke kërkuar sqarime **bazuar ne RRUOPP për Rastet c emergjencës ekstreme**

*50.2 Për rastet e emergjencës ekstreme - ekziston niundësia tëpërdoret procedura e negociuar pa publikuar njoftimin e kontratës, neni 35.2.1(iii) i LPP-së. Kjo procedurë mund të zhvillohet me një ose më shurnë Operatorë ekonomik të zgjedhur nga autoriteti kontraktues. Nuk ka afate minimale kohore që Hdhen me kryerjen e kësaj procedure, ky projekt ka qene Rastet e emergjencës ekstre*

Gjatë kërkesës për rishqyrtim kemi pretenduar se AK nuk e ka trajtuar dokumentin TECHNICAL DATA SHEET, të ngarkuar ne sistem e-prokurimi, por, pas pranimit të Vendimit për refuzim dhe arsyetimit, atëherë po

konstatohet se AK e ka trajtuar këtë dokument.

**Por**, arsyetimi i AK, nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e parapara në njoftim për kontratë, dosje të tenderit dhe specifika teknike dhe është në kundërshtim të plotë me nenin 59, pika 4 e LPP-së dhe me nenin 41, pika 41.11 e RRUOPP, citoj: *Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit*, kurse AK me këtë vendim, e vërteton se i ka tejkaluar kërkesat e parapara në NJK dhe DT dhe pa të drejtë na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit.

**Pse?** Sepse, Oferta jonë, sa i përket specifikave teknike ka qene 100% në harmoni me kërkesat e AK sa i përket: proteinave, kalorive, qëndrueshmërisë, **paketimit** etj., sepse kjo vërtetohet edhe nga dokumenti TECHNICAL DATA SHEET, që paketimi për ruajtje të vlerave ushqyese është sipas standardeve **BOPP/PET met/LDPE**.

Tash lindë pyetja?: A ka kërkuar AK ne Dosje të tenderit, njoftim për kontratë apo specifika teknike se, është e ndaluar që prodhimi i mishtit të jetë në një vend tjetër, kurse paketimit për ruajtje të vlerave të ushqimit nuk bënë të jetë nga një vend tjetër?. Përgjigjeje është **JO!**

Sa për sqarim: Prodhuesi i ushqimit sipas tenderit për **Furnizim me ushqim të terur për qentë zyrtar** është “VAFA PRAHO” nga R. Çekisë, kurse materiali për paketim, ruajtje etj., është kompania “Sacchettificio Nazionale G. Corazza” s.p.a, R. Italisë e specializuar për paketim me të gjitha ISO Standardet, prandaj edhe dokumenti TECHNICAL DATA SHEET, i lëshuar nga prodhuesi i ambalazhimit (paketimit) është për prodhuesin e mishrave “VAFA PRAHO” R. Çekisë, kurse importues për R. e Kosovës dhe bashkëpunues jemi ne, Klinika Veterinare “PET CARE” Sh.p.k, Prishtinë, të cilin produkt e importojmë si produkt final dhe të ambalazhuar sipas standardeve të BE-se.

Ky dokument i cili po ashtu është ngarkuar në e-prokurim pas kërkesave për sqarim nga AK, është dokument shtesë me qëllim të sqarimit në detaje të kërkesës së AK dhe, si alibi shtesë për të vërtetuar deklaratën tone me rastin e dorëzimit të tenderit, se paketimi për ruajtje të vlerave ushqyese është sipas standarde **BOPP/PET met/LDPE**.

Në vijim po e shkëpusim një pjesë të dokumentit TECHNICAL DATA SHEET, kurse këtë TECHNICAL DATA SHEET gjeni të bashkangjitur në fund të ankesës Arsyetimi tjetër i AK sa i përket nenit 50.2, lidhur me rastet e emergjencës ekstreme, për procedurat e negociuara pa publik të njoftimit për kontratë sipas nenit 35.2.1 (iii) të LPP-së **nuk qëndron** për faktin se, ne **nuk** e kemi kontestuar këtë procedurë të emergjencës ekstreme, por e kundërshtojmë arsyetimin e AK-së, për shkak se AK **nuk** iu është përmbajtur barazisë në trajtim në raport me

OE, sepse me datë 30.08.2021 ka dërguar ftesën, kurse hapjen e ka paraparë me 31.08.2021 ne ora 14:00h, pastaj kërkesa për sqarime shtese është dërguar me 01.09.2021, ndërsa afati për përgjigjeje ka qene data 02.09.2021 ne ora 12:00h, deri ne këtë fazë gjithçka ka qene ne pajtueshmëri me kërkesat e dispozitave Ligjore, por vlerësimi i ofertave deri ne vendim, edhe pse kemi qene vetëm 2 Operator Ekonomik ka zgjatë plotë 4 (katër) ditë deri me 06.09.2021. Nëse, AK thirret ne këtë procedurë për respektim të afateve vetëm nga ana OE, kurse vet nuk e respekton afatin kohorë për procedurat e emergjencës ekstreme, atëherë mund të konstatohet se AK vete ka ber shkelje të kësaj procedure, prandaj edhe arsyetimi është i pa qëndrueshëm.

Prandaj edhe me te drejte e kundërshtojmë në tersi vendimin e AK-se, **se pari**, për trajtimin si tenderues i eliminuar **se dyti**, për anulimin e aktivitetin e prokurimit dhe **se treti**, refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, për faktin se ne jemi të **përgjegjshëm** në kuptim të nenin 60, pika 1, par1.1 i LPP-së.

Bazuar në sqarimet dhe argumentet e cekura me lartë, pretendojmë se: AK, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-se, Neni 62, Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, paragrafin 1 dhe 2 dhe, në kundërshtim me neni 44 te Rregullave dhe UOPP. Rregullat dhe UOPP ne parag. 44.6 dhe 44.7 ku përcaktojnë kushtet se, kur mund te anulohet aktiviteti i prokurimit pas hapjes se tenderit.

Duke pasur parasysh faktet, argumentet, sqarimet e mjaftueshme sa i përket paketimit për ruajtjen e vlerave ushqyese, atëherë, kërkojmë nga organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP) që ankesën:

**J Të aprovoj Ankesën të bazuar,**

**J Të anuloj, Vendimin e AK për anulimin e aktivitetit te prokurimi,**

**Të kthej tenderin në Rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë, dosjes së tenderit , LPP si dhe Rregullat dhe UOPP.**

### **OE AL TEC pretendon se**

*Autoriteti Kontraktus -POLICIA E KOSOVËS ka bërë shkeljen e dispozitave të LPP-së dhe RRUOPP.*

2. *Neni 1 Qëllimi paragrafi 1 - LPP*
3. *Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti - LPP*
4. *Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1,2,3 dhe 6 - LPP*
5. *Neni 51 Njoftimi i Krieteve të Përzgjedhjes*
6. *Neni 52 Njoftimi i krieteve për dhënien e kontratës paragrafi 3 -LPP*
7. *Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave -LPP*
8. *Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve -LPP*
9. *Neni 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve - RRUOPP.*
10. *Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës paragrafi 60.1.1 Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë LPP*

Raporti i teknik, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE Pet Care”shpk dhe OE Al Tech shpk , , lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me ushqim te terur per qentë zyrtar”, me nr. të prokurimit: 214-21-5862-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosoves.

11. Neni 28. Kriteret e Dhënies së Kontratës pika 28.1.1 Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë RRUOPP
12. Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
13. Ligjit per Ushqim Ligji Nr.03\_L-016 per ushqimin, KREU VI, Neni 20,4

14. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me datën 06.09.2021, kemi pranuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe letrat standarde për anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyen: anulohen për shkak se asnjë nga ofertat e pranuar nuk janë të përgjegjshme. Ndërsa arsyetimi i AK për eliminim është

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, citoj:

a) **AL-TEC SH.P.K. -Nuk i përmbush specifikat teknike të ushqimit dhe paketimit duke ju referuar edhe sqarimit të OE, ku OE deklaron se në linjën e prodhimit të kompanisë momentalisht nuk prodhohet kështu produkt me specifikat e kërkuara të AK-së**

b) **Po ashtu OE deklaron se paketimin e ushqimit nuk mund ta sjell siç është kërkuar në specifikat teknike. Sqarim nga ana e OE.**

a) Kompania AL-Tec Sh.p.k., ashtu edhe siç është sqaruar në Përgjigje ndaj kërkesës për sqarim me datë 02.09.2021, ka deklaruar se ushqimin me specifikat e kërkuara nga ana e AK nuk e prodhon momentalisht por është teresisht i mundshëm pasi që prodhimi i ushqimit bëhet sipas kërkesave të tregut. Gjithashtu Përgjigjes ndaj kërkesës për sqarim i kemi bashkëngjitur deklaratën e AUV, ku si autoritet kompetent sqaron se kompania prodhuese duke u bazuar në kërkesat e tregut dhe nevojat e kategorive dhe specieve të kafshëve e përcakton nivelin e përqindjes së materialeve ushqyese. Kjo i jap të drejtë kompanisë prodhuese që në çdo moment, sipas kërkesave në treg të fillojë me prodhimin e produktit të ri sipas specifikacioneve teknike që kerkohen. Kompania AL-TEC Sh.p.k. gjithashtu ka realizuar fazën testuese të prodhimit të produktit sipas specifikacioneve të AK, andaj edhe jemi përgjigjur në Përgjigjen ndaj kërkesës për sqarim se ushqimi me vlerat e kërkuara është tersisht i mundshëm për prodhim pasi që disponojmë të gjitha mekanizmat për prodhim duke filluar nga mekanizmat për prodhim si dhe të stafit profesional që merret me përgaditjen e ushqimit sipas specifikacioneve të kërkuara për tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

Çdo kompani prodhuese e ka mundësinë e prodhimit të recepturave të ndryshme dhe të drejtën e prodhimit të një produkti të ri në çdo kohë gjithmonë sipas kërkesave të autoriteteve kontraktuese qoftë privat apo institucion sic është edhe me rastin me Policinë e Kosovës.

b) Paketimi i ushqimit - Kompania AL-Tec Sh.p.k., ashtu siç është sqaruar në Përgjigjen ndaj kërkesës për sqarim me datë 02.09.2021, ka deklaruar se paketimet ekzistuese të cilat i ka në stok, të cilat janë të punuara në baze të standardeve me të larta në baze të standardeve të HACCAP, për mbrojtje nga lageshtia, nga rrezatimet e Diellit, për ruajtje të aromës dhe vlerave ushqyese të ruajtjes së produkteve ushqyese, do të ngjitet deklaracioni i mallit i cili sipas Ligjit për Ushqim Ligji Nr.03\_L-016 për ushqimin, KREU VI, Neni 20,4 do të përmbajë keto shënime:

4. L emërtimin me të cilin ushqimi shitet;
- 4.2. listën mbi përshkrimin e përbërësve;
- 4.3. sasinë dhe kategorinë e përbërësve të caktuar;
- 4.4. sasinë neto për ushqimin e paketuar;

4.5. afatin e përdorimit;

4.6. kushtet e ruajtjes, kur ato munden të ndikojnë në skadencën e ushqimit;

4.7. emrin dhe adresën e prodhuesit ose emrin dhe adresën e atij që e paketon ose e plaslon në treg Gjithashtu sipas Ligjit për Ushqim Ligji Nr.03\_L-016 për ushqimin, KREU VI, Neni 20, 2, lejohet ngjitja e deklaracionit me stiker në paketime dhe citoj Nenin:

*Deklarata nënkupton të gjitha shenjat e shkruara, emërtimin tregtar, shenjën mbrojtëse, emërtimin e markës, paraqitjen e fotografive ose simbolin i cili i referohet ushqimit dhe vendoset në ambalazh, etiketën ngjitëse ose të varur dhe informatat të cilat e përcjellin ose i referohen atij ushqimi.*

Eshtë shkelur LPP neni 1.Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Oferta e jone është e përgjegjshme, kemi ofruar çmime me të ulet dhe kemi plotësuar specifikacionet teknike të kërkuara nga AK.

Eshtë shkelur LPP neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti -Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht dukemarrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit që është në pajtueshmëri me të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit

Eshtë shkelur LPP neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1-Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente dhe paragrafi 6 pika (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies. Me këtë AK ka bërë vlersimin e ofertave duke marrë për bazë se nëse prodhues nuk kemi prodhuar me heret këtë lloje të ushqimit sipas përqindjeve të kërkuara në Aneksin 1 të specifikacioneve teknike. në vlersimin e ofertave kriteret që nuk janë kërkuar në njoftimin për kontrat dhe në dosjen e tenderit.

Është shkelur LPP Neni 51 Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes paragrafi 1 I.Autoriteti kontraktues duhet të theksojë në njoftimin e kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet të përmbushë për të konsideruar si i kualifikuar: (i) në rast të procedurave të hapura dhe procedurave të kuotimit të çmimit për dhënie të një kontrate; ose (ii) në rast të procedurave të kufizuara ose procedurave konkurruese me negociatë , për të pranuar një ftesë për tenderim. Për faktin se jemi ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim me ulet sa i përket kriterëve të përzgjedhjes, AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e përzgjedhjes të parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit



dhe pa te drejte pa asnjë bazë ligjore na eliminon nga aktiviteti i mëtejshëm i prokurimit edhe pse ju kemi bere te qart ne sqarimet e kerkuara se i plotesojme te gjitha specifikacionet teknike te kerkuara ne dosjen e tenderit. Ne kemi qene të përgjegjshëm dhe ne pajtueshmëri të plotë me kriteret e parapara në njoftim për kontratë dhe DT dhe, AK nuk ka as një arsye të vetme që të na eliminoj neve si OE të pa përgjegjshëm se nuk kemi prodhuar kete lloj ushqimi me recepturen e kerkuara nga AK dhe ne kundërshtim me LPP ka bere anulimin në tersi te ketij Aktiviteti te Prokurimit.

Është shkelur LPP Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës paragrafi 1 - Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret ka qenë tenderi me çmim më i ulët. Paragrafi 3 -Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit aneksi 1 mund të shfrytëzohen për vlerësimin e ofertave.

Eshte shkelur LPP Neni 56.3 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave paragrafi 56.3. - Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit aneksi 1. Çdo kompani prodhuese e ka mundësinë e prodhimit të recepturave të ndryshme dhe të drejtën e prodhimit të një produkti të ri në çdo kohë gjithëmonë sipas kërkesave të autoriteteve kontraktuese qoftë privat apo institucion sic është edhe me rastin me Policinë e Kosovës. Sqarimet janë dhënë edhe në kërkesën për sqarime që është kërkuar nga ana e juaj, duke ju dhënë përgjigje të se mund të bëjmë prodhimin e këtij lloji ushqimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara në dosjen e tenderit. Kete e postecion edhe AVUK ku prodhuesi i ka te gjitha mundesit te pergadite speciet sipas kërkesave në treg.

Eshte shkelur LPP Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve Autoriteti kontraktues ka bere vlerësimin e ofertave duke na eliminuar si ofertë e pa përgjeshme në specifikacionet teknike mirpo ne si prodhues i kemi plotësuar te gjitha specifikacionet teknike qe jane kerkuara ne Aneksin 1 ku edhe ne sqarimet e kerkuara ju kemi bere me dije qe mundsit teknike dhe profesionale te prodhuesit jane per prodhimin e ketij lloje ushqimi me keto specifika por edhe cfaredo ushqimi tjeter qe kerkohet. Gjithashtu kemi deklaruar se paketimeve ekzistuese te cilat i kemi ne stok, te cilat jane te punuara ne baze te standardeve me te larta ne baze te standardeve te HACCAP, per mbrojtje nga lageshtia, nga rrezatimet e Diellit, per ruajtje te aromes dhe vlerave ushqyese te ruajtjes se produkteve ushqyese jane konforme kërkesave ne specifikacionin teknike si dhe do ti ngjitet deklaracioni i mallit i cili sipas Ligjit per Ushqim Ligji Nr.03\_L-016 per ushqimin, KREU VI, Neni 20,4. Pra me kete ne si ofertues i plotesojm te gjitha kriteret dhe specifikacionet teknike te kerkuara nga AK.

4.1. Eshte shkelur RRUOPP Neni 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve paragrafi 41.1 autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacionet ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit. Ne kete rast komisioni i vlerësimit nuk ka bere vlerësimin sipas specifikacionin teknike te detyrueshme tenderit. Paragrafi 41.3 Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP janë: 5- Vetëm kërkesat dhe kriteret e dhënies së kontratës të

specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim. Ne kete rast Autoriteti kontraktues nuk ka bere vlersimin e ofertes sipas specifikacioneve teknike te detyrueshme te kerkuara ne dosjen e tenderit Aneksi 1 edhe ne ju kemi sqaruar se ne si prodhues i kemiplotesuar te gjitha specifikacionet teknike qe jane kerkuara ne Aneksin 1 ku edhe ne sqarimet e kerkuara ju kemi bere me dije qe mundsit teknike dhe profesionale te prodhuesit jane per prodhimin e ketij lloje ushqimi me keto specifika por edhe cfaredo ushqimi tjeter qe kerkohet. Gjithashtu kemi deklaruar se paketimeve ekzistuese te cilat i kemi ne stok, te cilat jane te punuara ne baze te standardeve me te larta ne baze te standardeve te HACCAP, per mbrojtje nga lageshtia, nga rrezatimet e Diellit, per ruajte te aromes dhe vlerave ushqyese te ruajtjes se produkteve ushqyese jane konforme kerkesave ne specifikacionin teknike si dhe do ti ngjitet deklaracioni i mallit i cili sipas Ligjit per Ushqim Ligji Nr.03\_L-016 per ushqimin, KREU VI, Neni 20,4. do tepermbaj keto shenime: emërtimin me të cilin ushqimi shitet;

4.2. listën mbi përshkrimin e përbërësve;

4.3. sasinë dhe kategorinë e përbërësve të caktuar;

4.4. sasinë neto për ushqimin e paketuar;

4.5. afatin e përdorimit;

4.6. kushtet e ruajtjes, kur ato munden të ndikojnë në skadencën e ushqimit;

4.7. emrin dhe adresën e prodhuesit ose emrin dhe adresën e atij që e paketon ose e plason në treg

Gjithashtu sipas Ligjit per Ushqim Ligji Nr.03\_L-016 per ushqimin, KREU VI, Neni 20, 2, lejohet ngjitja e deklaracionit me stiker ne paketime dhe citoj Nenin:

Deklarata nënkupton të gjitha shenjat e shkruara, emërtimin tregtar, shenjën mbrojtëse, emërtimin e markës, paraqitjen e fotografive ose simbolin i cili i referohet ushqimit dhe vendoset në ambalazh, etiketën ngjitëse ose të varur dhe informatat të cilat e përcjellin ose i referohen atij ushqimi. Pra me kete ne si ofertues i plotesojm te gjitha kriteret dhe specifikacionet teknike te kerkuara nga AK.

Është shkelur LPP Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës paragrafi 60.1.1 Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë

Është shkelur RRUOPP Neni 28. Kriteret e Dhënies së Kontratës pika 28.1.1 Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë

Është shkelur LPP neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit pasi që ne si OE jemi plotësisht si ofertues i përgjegjshëm pasi qe i plotesojm te gjitha kriteret e kerkuara.

Është shkelur Ligjit per Ushqim Ligji Nr.03\_L-016 per ushqimin, KREU VI, Neni 20,4 do te permbaj keto shenime:

4.1. emërtimin me të cilin ushqimi shitet;

4.2. listën mbi përshkrimin e përbërësve;

4.3. sasinë dhe kategorinë e përbërësve të caktuar;

4.4. sasinë neto për ushqimin e paketuar;

4.5. afatin e përdorimit;

4.6. kushtet e ruajtjes, kur ato munden të ndikojnë në skadencën e ushqimit;



**4.7. emrin dhe adresën e prodhuesit ose emrin dhe adresën e atij që e paketon ose e plasën në treg**  
Gjithashtu sipas Ligjit për Ushqim Ligji Nr.03\_L-016 për ushqimin, KREU VI, Neni 20, 2, lejohet ngjitja e deklaracionit me stiker në paketime dhe citoj Nenin:

*Deklarata nënkupton të gjitha shenjat e shkruara, emërtimin tregtar, shenjën mbrojtëse, emërtimin e markës, paraqitjen e fotografive ose simbolin i cili i referohet ushqimit dhe vendoset në ambalazh, etiketën ngjitëse ose të varur dhe informatat të cilat e përcjellin ose i referohen atij ushqimi*

Ne perfundim të prezentimit të argumenteve përmes kësaj Ankese, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlersim dhe të merret

**VENDIM**

**APPROVOHET**, ankesa si e bazuar e OE “AL-TEC”

**ANULOHET** Vendimi, perkatesisht Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i publikuar në web faqen e Eprokurimit me datë 06.09.2021 dhe lenda të kthehet në RIVLERSIM

**DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlersimit, ekzaminimit, vlersimit dhe krahasimi i ofertave të bëhet sipas kriterëve të dosjes së tenderit si dhe konforme LPP, RRUOPP, Ligjit për Ushqim Nr.03\_L-016 për ushqimin

**TE SHPALLET FITUES** Operatori Ekonomik “AL-TEC” pasi që kemi ofertë të përgjegjshme me cmim me të ulët. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

***Për secilin pretendim, çështjet e mëposhtme nga ankesa duhet të përmbledhen:***

- a) pretendimi, d.m.th. çfarë veprimi / mosveprimi / vendimi ka ndërmarrë autoriteti kontraktues i cili konsiderohet i paligjshëm.
- b) dispozita e LPP-së ose ligji detyrues që pretendohet se është shkelur.
- c) argumentet e ankuesit në mbështetje të pretendimit.

### **3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET**

#### **Kapaciteti teknik dhe profesional**

Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog broshurë nga prodhuesi me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi 1)., Dëshmi 1 Katalogë broshurë nga prodhuesi me përshkrime të specifikacioneve teknike siç kërkohet në specifikacionin teknik (Aneksi 1).

### **4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES**

Raporti i teknik, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE Pet Care”shpk dhe OE Al Tech shpk , lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me ushqim të terur për qentë zyrtar”, me nr. të prokurimit: 214-21-5862-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës.

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

*AK, anulon aktivitetin e prokurimit ne munges te ofertave te pergjegjeshme.*

## 5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA .

## 6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

## 7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

**Sqarim hyrës:** Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të mesme (kontrat kornizë 36 muaj). Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për anulim te aktivitetit te prokurimit. Eksperti shqyrtues sqaron se të gjitha pretendimet ankimore janë trajtuar nga eksperti teknik dhe atë si më poshtë:

### **Përgjigje në pretendime ankimore:**

Përgjigjia e ekspertit teknik per specifikat teknike:

Sa i përket ankesës së dy OE ndaj vendimit të AK për eliminimin nga tenderimi për mospërmbushje të specifikave teknike të detyrueshme, gjegjësishtë AK në raportin e vlerësimit të tenderëve deklaron se Pet Care nuk i përmbush specifikat e paketimit dhe Al-Tec nuk i përmbush specifikat teknike të ushqimit dhe paketimit.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit si ekspert i jashtem teknik vlerësoj se AK në DT ka kërkuar ***Katalog/broshure me karakteristika teknike të prodhuesit në detaje me te cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike te ofruara*** ku si specifika teknike të detyruara AK kërkon që produkti të përmbaj ***Proteina 30-34%, Yndyra 22-24%, mish të shpendeve ose mish të gjedhit, Omega 3 dhe Omega 6, ndersa Paketimi i Ushqimit duhet te ketë material për ruajtjen e vlerave ushqyese te ushqimit me standarde BOPP/PET met/LDPE.***

Konstatoj se të dy OE ankues kanë dorëzuar vetëm katalogun me specifikat e përmbajtjes së ushqimit nga prodhuesi sipas DT dhe nuk i kanë siguruar specifikat e paketimit të produktit sipas kërkesës së AK. Andaj konstatoj se pretendimi per specifikat teknike eshte i pa bazuar.

## 8. MENDIMI I EKSPERTIT TEKNIK

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankues të refuzohen si të pa bazuara dhe njoftimi për anulim të AP-se të mbetet në fuqi.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – XXXXXXXXXXXX.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues – XX.